



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06

**Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

**Vendosi:** Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 27 korrik 2023

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Konfidencial

---

**Vendimi i Tretë mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e  
Provave Jogojore**

---

**Ushtruesit të Detyrës së  
Zëvendësprokurorit të Specializuar**  
Vard Ferdinandse

**Mbrojtësit të Viktimave**  
Sajmon Loz

**Mbrojtjes së Hashim Thaçit**  
Gregori Kihou

**Mbrojtjes së Kadri Veselit**  
Ben Emerson

**Mbrojtjes së Rexhep Selimit**  
Xhefri Roberts

**Mbrojtjes së Jakup Krasniqit**  
Venkatesvari Alagenda

**TRUPI GJYKUES II** ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 21, 40(2) dhe (6)(h) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 137 dhe 138(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 16 dhjetor 2022, Trupi Gjykues i kërkoi Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS") të dorëzonte një mocion për prova jогоjore lidhur me: (i) provat e propozuara në listën e provave materiale që synon të përdorë me secilin prej 40 dëshmitarëve të saj të parë; dhe (ii) materialet provuese që ZPS-ja mendon se janë të rëndësishme për një paraqitje sa më të qartë e të efektshme të argumenteve të saj në këtë fazë të procesit ("Urdhri i Katërt Gojor").<sup>1</sup>

2. Më 8 shkurt 2023, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi një kërkesë për pranimin e materialeve si prova jогоjore ("Mocioni i Provave Jогоjore").<sup>2</sup>

3. Më 21 shkurt 2023, pas kërkesës së Mbrojtjes së Hashim Thaçit ("z. Thaçi"), Kadri Veselit ("z. Veseli"), Rexhep Selimit ("z. Selimi") dhe Jakup Krasniqit ("z. Krasniqi") ("të akuzuarit" dhe "Mbrojtja"), Trupi Gjykues e zgjati afatin për përgjigje ndaj Mocionit të Provave Jогоjore deri më 21 mars 2023.<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup> Transkript i Seancës, Trupi Gjykues, 16 dhjetor 2022, f. 1775, rreshti 6 deri f. 1776, rreshti 5.

<sup>2</sup> F01268, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Pranimin e Provave Jогоjore*, 8 shkurt 2023, me Shtojcat 1-4, 6, 7, konfidenciale, dhe me Shtojcat 5, 8.

<sup>3</sup> F01309, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Mocion të Rishikuar për Provat Jогоjore dhe Pezullim e Zgjatje Afati*, 21 shkurt 2023, para. 15, 16(c).

4. Më 21 mars 2023, Mbrojtja iu përgjigj Mocionit të Provave Jogojore (“Përgjigjja”).<sup>4</sup>

5. Më 31 mars dhe më 9 qershor 2023, Trupi Gjykses lëshoi dy vendime me anë të cilëve trajtonte pjesërisht Mocionin e Provave Jogojore (përkatësisht, “Vendimi mbi Mocionin e Provave Jogojore” dhe “Vendimi i Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore”).<sup>5</sup>

## II. PARASHTRIMET

6. ZPS-ja kërkon pranimin si prova jogojore të materialeve që u përkasin gjashtë kategorive: (i) komunikata, deklarata politike dhe njoftime të tjera të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“UÇK”); (ii) projekte të deklaratave publike të UÇK-së, që janë sekuestruar nga z. Krasniqi; (iii) arkiva të botuara të agjencisë së lajmeve të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së “Radio Kosova e Lirë”; (iv) arkivat e agjencisë së lajmeve të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së “Kosovapress” ribotuar në organe të tjera të medias; dhe (vi) materiale të tjera të cilat nuk i përkasin një kategorie të veçantë por janë brenda kuadrit të Urdhrit të Katërt Gojor.<sup>6</sup>

7. Mbrojtja përgjigjet se Mocioni i Provave Jogojore është përpjekje e paarsyeshme dhe dëmtuese për pranimin e një volumi tejet të madh provash duke iu shmangur kontrollit të drejtë dhe kërkesës që dokumentet të vërtetohen dhe verifikohen gjatë paraqitjes përmes dëshmitarit përkatës.<sup>7</sup> Mbrojtja parashtron se ZPS-ja nuk ka zbatuar udhëzimin e Trupit Gjykses që standardi i vlerësimit të jetë i lartë me qëllim që të paraqiten për pranim vetëm provat me vlerë të lartë

---

<sup>4</sup> F01387, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Përbashkët e Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore*, 21 mars 2023, konfidenciale, me Shtojcat 1-8, konfidenciale.

<sup>5</sup> F01409, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore*, 31 mars 2023, konfidencial; F01596, Trupi Gjykses, *Vendimi i Dytë mbi Kërkesën e Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore*, 9 qershor 2023, konfidencial.

<sup>6</sup> Mocioni i Provave Jogojore, para. 2.

<sup>7</sup> Përgjigjja, para. 1.

provuese.<sup>8</sup> Mbrojtja shton se një qasje e tillë do të krijonte një dokumentacion të zmadhuar të gjyimit dhe do të minonte drejtësinë e procesit duke u larguar dukshëm nga parimi udhëheqës se argumentet duhet të jenë gojore, publike dhe ballafaqese, gjë që as nuk e përshpejton gjykimin as mundëson një gjykim të drejtë të çështjes gjyqësore.<sup>9</sup> Gjithashtu, Mbrojtja kundërshton në përgjithësi pranimin si prova jोगore të 13 kategorive të ndryshme të provave dokumentare dhe në veçanti, të një numri materialesh të tjera.<sup>10</sup>

### III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

8. Dispozitat ligjore përkatëse lidhur me aspektet aktuale gjenden, ndër të tjera, në nenet 21 dhe 40(6)(h) dhe rregullat 137 dhe 138(1), dhe janë shtjelluar gjerësisht në Vendimin mbi Mocionin e Provave Jोगore.<sup>11</sup> Trupi Gjykues zbaton të njëjtat standarde edhe për vendimin aktual.

### IV. DISKUTIM

#### A. ASPEKTE PARAPRAKE

9. Trupi Gjykues vë në dukje se në Vendimin mbi Mocionin e Provave Jोगore dhe në Vendimin e Dytë mbi Mocionin e Provave Jोगore, u dha përparësi materialeve që ZPS-ja kishte identifikuar se lidheshin përkatësisht me gjashtë dëshmitarët e parë dhe me gjashtë dëshmitarët pasues. Vendimi aktual i plotëson këto vendime duke trajtuar Shtojcën 1 të Mocionit të Provave Jोगore, me përjashtim të materialeve që janë sekuestruar nga banesat e z. Krasniqi ose z. Selimi pasi për këto materiale do të ketë një vendim të veçantë.

---

<sup>8</sup> Përgjigjja, para. 3.

<sup>9</sup> Përgjigjja, para. 4.

<sup>10</sup> Përgjigjja, para. 14-105; Shtojcat 1-6 të Përgjigjes.

<sup>11</sup> Vendim mbi Mocionin e Provave Jोगore, para. 8-13.

10. Në këtë fazë, Trupi Gjykses nuk do të shqyrtojë pranimin e një dokumenti për të cilin ZPS-ja nuk ka dorëzuar variantin e duhur në anglisht.<sup>12</sup>
11. Më tej, Trupi Gjykses vëren se një nga dokumentet që duhej shqyrtuar në vendimin aktual është pranuar tashmë si provë.<sup>13</sup> Për këtë arsye, kërkesa për pranimin e tij si provë jогоjore është e tejkaluar.
12. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se shtatë prej dokumenteve janë kopje, ose versione me cilësi më të dobët, të dokumenteve të tjera të paraqitura në Mocionin e Provave Jогоjore.<sup>14</sup> Trupi Gjykses nuk e ka të qartë se përse nevojitet pranimi i kopjeve të të njëjtit dokument. Rrjedhimisht, në këtë fazë, Trupi Gjykses nuk i pranon si prova jогоjore materialet IT-03-66 P142, SPOE00209433-00209433, U000-9948-U000-9948, U000-0516-U000-0516, U000-9963-U000-9963, SITF00316652-00316655, dhe SITF00436539-00436539.<sup>15</sup> Në raste të tjera, Trupi Gjykses ka pranuar si prova disa versione të të njëjtit dokument apo dokumenteve të ngjashme që nuk ishin kopje të njëri-tjetrit, siç është shembulli i një komunikate të botuar nga dy a më shumë organe shtypi.

---

<sup>12</sup> Trupi Gjykses vëren se është i pasaktë përkthimi i SPOE40000794-40000794-ës pasi në shqip është deklarata 8, kurse në anglisht është komunikata 75; *Shih* Shtojcën 1 të Mocionit për Pranimin e Provave Jогоjore, materiali 32.

<sup>13</sup> Trupi Gjykses vëren se IT-04-84 P00948.E/U016-2727-U016-2728-EDT (materiali 1V në Shtojcën 1 të Mocionit për Pranimin e Provave Jогоjore) është pranuar si prova P0021/P0021\_ET.

<sup>14</sup> Trupi Gjykses vëren se: (i) U008-1602-U008-1636 (f. U008-1633), U000-9948-U000-9948 dhe U000-0516-U000-0516 janë të njëjtë; (ii) SITF00436539-00436539 është version me cilësi më të dobët i SPOE00053667-SPOE00053667-ET (materiali 1T në Shtojcën 4 të Mocionit për Pranimin e Provave Jогоjore); (iii) SPOE00209433-SPOE00209433-ET e rishikuar 1 dhe SPOE00209433-00209433 janë të njëjtë; (iv) U008-1622-U008-1622-ET.02 dhe U000-9963-U000-9963 janë të njëjtë (numri ERN në anglisht i U000-9963-U000-9963-it në Shtojcën 1 është U008-1622-U008-1622-ET.02); (v) IT-03-66 P142 dhe U016-2148-U016-2148 janë të njëjtë Trupi Gjykses vëren se ekziston një ndryshim i vogël në variantet në anglisht për shkak të shënimit me shkrim dore në dokumentin e dytë por e gjykon të panevojshëm pranimin e të dyve); dhe (vi) IT-03-66 P146 dhe SITF00316652-00316655 janë të njëjtë (Trupi Gjykses vëren se versionet në anglisht nuk janë të njëjtë por e konsideron autentik variantin origjinal në shqip).

<sup>15</sup> Shtojca 1 e Mocionit për Prova Jогоjore, materialet 24, 27, 32A, 32B, 51, 53B, 65.

B. SHTOJCA 1 – KOMUNIKATAT E SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË UÇK-SË, DEKLARATAT POLITIKE DHE DEKLARIMET E TJERA PUBLIKE NË EMËR TË SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË UÇK-SË

13. ZPS-ja kërkon pranimin si provë të: (i) një libri të Gafurr Elshanit (“z. Elshani”) me titull “Ushtria Çlirimtare e Kosovës: Dokumente dhe Artikuj”, botuar nga “Zëri i Kosovës”, në shqip, dhe 31 pjesë të këtij libri në anglisht.<sup>16</sup> ZPS-ja pretendon se z. Elshani, ish-drejtor dhe kryeredaktor i “Zërit të Kosovës”, mbledhi komunikata të UÇK-së dhe artikuj të botuar për këtë libër, të cilin e përpiloi dhe botoi “Zëri i Kosovës” në Prishtinë; (ii) një përmbledhjeje prej 28 deklaratash publike të UÇK-së botuar në gazeta të ndryshme në Kosovë në vitin 1997 dhe 1998;<sup>17</sup> (iii) një përmbledhjeje të komunikatave (përfshirë ato me numër 33-92), deklaratave politike (përfshirë ato me numër 8-32) dhe deklaratave të UÇK-së, të botuara midis 20 majit 1997 dhe 18 gushtit 1999; dhe (iv) 56 komunikatave, deklaratave politike dhe deklarimeve të tjera politike.<sup>18</sup> ZPS-ja parashtron se këto dokumente kanë lidhje me lëndën, janë autentike dhe kanë vlerë provuese dhe se pranimi i tyre si prova nuk dëmton Mbrojtjen.<sup>19</sup>

---

<sup>16</sup> Trupi Gjykses mban parasysh kërkesat e ZPS-së për pranimin e 35 pjesëve nga libri i z. Elshani në materialin 1 në Shtojcën 1 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, por njëra nga këto pjesë është pranuar në sallën e gjyqit dhe tre pjesë janë pranuar përmes Vendimit të Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore; *Shih* Shtojcën 1 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialet 1V, 1W, 1X dhe 1G2; *Shih më lart*, para. 11; Vendimi i Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore, para. 69-77.

<sup>17</sup> Trupi Gjykses vëren se në materialin 2 në Shtojcën 1 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore ZPS-ja kërkon pranimin si prova të 30 deklaratave publike të UÇK-së por se dy nga këto dokumente janë pranuar si prova përmes Vendimit të Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore; *Shih* Shtojcën 1 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialet 2J, 2M; Vendimin e Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore, para. 69-77.

<sup>18</sup> Trupi Gjykses vëren se në materialet 4-69 në Shtojcën 1 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore ZPS-ja kërkon pranimin si prova të 84 materialeve që janë komunikata, deklarata politike dhe deklarata të tjera publike të UÇK-së, por shënon se: (i) tetë materiale janë hedhur poshtë më lart në paragrafët 10 dhe 12; (ii) dhjetë materiale janë pranuar si prova përmes Vendimit të Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore; dhe (iii) dhjetë materiale nuk trajtohen nga vendimi aktual pasi janë sekuestruar nga të akuzuarit; *Shih* Shtojcën 1 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialet 16, 27, 29A, 31, 31A, 32, 32A, 32B, 35-37, 37A, 38, 39A, 40, 43-44, 47-48, 48A, 51, 62, 63A, 65-67; *Shih gjithashtu më lart*, para. 10, 12; Vendimin e Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore, para. 69-77, 145-153.

<sup>19</sup> Mocioni i Provave Jogojore, para. 3; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore.

14. Mbrojtja e kundërshton pranimin si prova jогоjore të komunikatave të paraqitura në Shtojcën 1 të Mocionit të Provave Jогоjore. Konkretisht, Mbrojtja parashtron se shumë prej këtyre komunikatave janë paraqitur përmes dëshmitarëve para Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë ("TPNJ") trupat gjykues të të cilit thuhet se kanë pranuar se: (i) këto dokumente janë shkruar nga individë të ndryshëm, përfshirë komandantët e zonave, pa dijeninë e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së; (ii) janë shfrytëzuar si mjet propagandistik; dhe (iii) për t'i shërbyer kësaj fushate, përmbajtja e tyre shpesh është fryrë ose ndryshuar.<sup>20</sup> Mbrojtja argumenton se këto konstatime të pretenduara hedhin dyshime thelbësore mbi besueshmërinë dhe autenticitetin e këtyre dokumenteve, të cilat, *prima facie*, nuk përmbushin kriteret e rregullës 138.<sup>21</sup> Gjithashtu, Mbrojtja parashtron edhe se, duke qenë se disa prej këtyre dokumenteve janë pa nënshkrim, pa vulë, nganjëherë pa datë, me autorë të panjohur, nuk është i qartë burimi i informacionit mbi bazën e të cilit janë shkruar këto dokumente dhe se nuk janë të disponueshme versionet "origjinale", këto dokumente nuk plotësojnë kriteret për pranim si prova pa kontekstin që paraqitet përmes dëshmitarit.<sup>22</sup> Më tej, Mbrojtja paraqet kundërshtime konkrete lidhur me një numër të madh të materialeve të lartpërmendura.<sup>23</sup>

15. Trupi Gjykues vëren se ZPS-ja kërkon pranimin si provë të dokumenteve në tërësinë e tyre në shqip ndërkohë që ofron vetëm përkthime të pjesshme në anglisht. Në kontekstin e vendimit aktual, Trupi Gjykues ka vlerësuar vetëm pranueshmërinë e pjesëve të këtyre dokumenteve të cilat janë të disponueshme në anglisht. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues hedh poshtë kërkesën për pranimin në tërësi si provë jогоjore të U016-2551-U016-2818-ës (materiali 1 në Shtojcën 1).

---

<sup>20</sup> Përgjigjja, para. 16.

<sup>21</sup> Përgjigjja, para. 17.

<sup>22</sup> Përgjigjja, para. 17.

<sup>23</sup> Shtojca 1 e Përgjigjes.



16. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se në parashtrimet për pranueshmërinë e disa materialeve që përfshihen në materialet 1 dhe 2 të Shtojcës 1, ZPS-ja ka përdorur numrin e regjistrimit të provës ("ERN") të përkthimeve në anglisht. Rrjedhimisht, edhe Trupi Gjykses u është referuar këtyre materialeve përmes numrave të njëjtë të regjistrimit të provës.

### 1. Materiali 1 në Shtojcën 1

17. Tridhjetenjë pjesët në anglisht nga libri i z. Elshani (materiali 1 në Shtojcën 1) përshijnë parathënien e librit<sup>24</sup> si dhe dokumente të ribotuara nga burime të tjera, konkretisht: (i) deklaratën politike të mbledhjes së katërt të përgjithshme të Lëvizjes Popullore të Kosovës ("LPK") botuar nga "Zëri i Kosovës";<sup>25</sup> (ii) një deklaratë për shtyp nga "media serbe" ku thuhej se UÇK-ja "ka marrë përsipër veprën penale në Glllogoc";<sup>26</sup> (iii) një artikull me titull "Luftë për Liri apo... Terrorizëm" botuar nga "Zëri i Kosovës";<sup>27</sup> (iv) komunikatat 13, 18-21, 24, 26-30, 32-34, 38-41, 44, 46, të gjitha me përjashtim të njëjës (komunikata 21) botuar fillimisht nga "Zëri i Kosovës";<sup>28</sup> (v) një deklaratë me titull "Mbrojtja e Kosovës është e Drejtë e Pacenueshme, e Patjetërsueshme dhe Obligim e Nder i Çdo Qytetari", botuar nga "Zëri i Kosovës" më 1 maj 1996;<sup>29</sup> (vi) një deklaratë me titull

---

<sup>24</sup> IT-04-84 P00934.E, Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1A.

<sup>25</sup> IT-04-84 P00933.E; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1B.

<sup>26</sup> ET U016-2577-U016-2578; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1C.

<sup>27</sup> ET U016-2579-U016-2582; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1D.

<sup>28</sup> U016-2583-U016-2583-ET e rishikuar, U016-2588-U016-2589-ET e rishikuar, U016-2603-U016-2604-ET e rishikuar, U016-2609-U016-2609-ET e rishikuar, U016-2619-U016-2620-ET e rishikuar, U016-2625-U016-2625-ET e rishikuar, ET U016-2631-U016-2631, U016-2653-U016-2654-ET e rishikuar, U016-2666-U016-2666-ET e rishikuar, ET U016-2667-U016-2668, ET U016-2676-U016-2676, U016-2708-U016-2708-ET e rishikuar, U016-2710-U016-2710-ET, U016-2750-U016-2750-ET, U016-2751-U016-2752-ET, IT-04-84 P00953.E, IT-04-84bis P00147.E, U016-2781-U016-2782-ET, U016-2793-U016-2794-ET; *Shih* Shtojcën 1 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materialet 1E, 1F, 1G, 1I, 1J, 1L, 1M, 1N, 1O, 1P, 1R, 1S, 1T, 1Y, 1Z, 1B2, 1E2, 1H2, 1I2. Trupi Gjykses vëren se komunikatat 36-37 dhe 42 janë pranuar si prova përmes Vendimit të Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore; *Shih* Vendimin e Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore, para. 69-77.

<sup>29</sup> ET U016-2606-A-U016-2606-B; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1H.



“Aksione të Reja të UÇK-së”, botuar nga “Zëri i Kosovës” më 29 gusht 1996;<sup>30</sup> (vii) një deklaratë me titull “UÇK-ja Është Një Realitet”, me autor “Ali Ukajn”, botuar nga “Gazetën Shqiptare” më 31 janar 1997;<sup>31</sup> (viii) një raport me titull “UÇK-ja Merr Përgjegjësi për Tre Sulme”, ribotuar nga “Qendra për Informim e Kosovës” më 1 gusht 1997;<sup>32</sup> (ix) një intervistë e Korporatës Britanike të Transmetimeve (“BBC”) me Fehmi Aganin, ribotuar nga “Rilindja” më 3 dhjetor 1997;<sup>33</sup> (x) një thirrje drejtuar shqiptarëve për të ndihmuar Lëvizjen Kombëtare të Kosovës, botuar nga “Zëri e Kosovës”;<sup>34</sup> (xi) një botim me titull “Glllogoc: Mbështetje e vazhdueshme nga njerëz të pidentifikuar”, botuar nga “Qendra për Informim e Kosovës” më 27 dhjetor 1997;<sup>35</sup> dhe (xii) një përmbledhje të tre materialeve të botuara, që përbëhet nga dy deklaratatë të UÇK-së si dhe komunikata 42.<sup>36</sup>

18. Trupi Gjykues konstaton se këto materiale kanë lidhje me pretendimet e paraqitura në Aktakuzën e Ndryshuar për shkak se kanë të bëjnë me një a më shumë prej aspekteve vijuese: (i) marrëdhënien ndërmjet LPK-së dhe UÇK-së; (ii) sfondin dhe kohën kur është shfaqur UÇK-ja; (iii) sulmet e pretenduara të anëtarëve të UÇK-së kundër të ashtuquajturve “bashkëpunëtorë”; (iv) mbikëqyrjen e operacioneve ushtarake nga Shtabi Qendror i UÇK-së dhe Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së; (v) sulmet e armatosura dhe ekzistencën e konfliktit të armatosur; (vi) statusin që pretendohet se kishte Shtabi Qendror i UÇK-së dhe Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së si zëri i vetëm i ligjshëm i popullit shqiptar të Kosovës; (vii) përdorimin e komunikatave dhe deklaratave politike nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, përfshirë edhe lidhur me të ashtuquajturit

<sup>30</sup> U016-2621-U016-2621-ET e rishikuar; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1K.

<sup>31</sup> IT-04-84 P00946.E; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1Q.

<sup>32</sup> U016-2726-U016-2726-ET e rishikuar; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1U,

<sup>33</sup> U016-2757-U016-2757-EDT; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1A2.

<sup>34</sup> ET U016-2762-U016-2762; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1C2.

<sup>35</sup> U016-2775-U016-2775-ET; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1D2.

<sup>36</sup> ET U016-2778-U016-2779; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1F2.

bashkëpunëtorë; (viii) rolin, kompetencat dhe autoritetin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së; dhe (ix) mundësitë operative të UÇK-së.<sup>37</sup> Trupi Gjykses vëren se të gjithë këta materiale, me përjashtim të dy prej tyre, mbajnë datë që del jashtë kuadrit kohor të Aktakuzës së Ndryshuar<sup>38</sup> dhe juridiksionit kohor të Dhomave të Specializuara (“DHS”). Megjithatë, Trupi Gjykses konstaton se këto materiale kanë lidhje me lëndën pasi ngjarjet që i paraprijnë periudhës së aktakuzës, ose kuadrit kohor të DHS-së, përbëjnë sfond relevant lidhur me ngjarje që përfshihen në kuadrin kohor të Aktakuzës së Ndryshuar.<sup>39</sup> Më konkretisht, këto materiale janë dëshmi e mënyrës së veprimit që ka lidhje me faktet e pretenduara sipas Aktakuzës së Ndryshuar.

19. Trupi Gjykses rikujton konstatimin e vet nga Vendimi i Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore se autorësia e komunikatave, deklaratave politike dhe deklarimeve të tjera të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së do të qartësohet gjatë gjykimit.<sup>40</sup> Ky konstatim vlen për të gjitha dokumentet e kësaj natyre të Shtojcës 1 që trajtohen në vendimin aktual. Në mënyrë të ngjashme, qëllimi i këtyre komunikatave do të vlerësohet në fund të gjykimit mbi bazën e tërësisë së provave përkatëse. Megjithatë, si përgjigje ndaj parashtrimeve të Mbrojtjes mbi këtë pikë, Trupi Gjykses vë në dukje se nuk është në dijeni që trupat gjykuese të TPNJ-së të kenë arritur në konstatimin se komunikatat janë përdorur vetëm për qëllime

---

<sup>37</sup> F00999/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Parashtrimit të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar*, (“Aktakuza e Ndryshuar”), 30 shtator 2022, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (riklasifikuar si konfidenciale më 26 janar 2023), para. 14-16, 20, 36.

<sup>38</sup> Aktakuza e Ndryshuar, para. 16.

<sup>39</sup> International Criminal Tribunal for Rwanda, *Prosecutor v. Théoneste Bagosora et al.*, ICTR-98-41-T, Trial Chamber I, [Decision on Admissibility of Proposed Testimony of Witness DBY](#), 18 September 2003, para. 10; *Ferdinand Nahimana et al. v. Prosecutor*, ICTR-99-52-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 28 November 2007, para. 315; *Aloys Simba v. Prosecutor*, ICTR-01-76-AR72.2, Appeals Chamber, [Decision on Interlocutory Appeal Regarding Temporal Jurisdiction](#), 29 July 2004, p. 3; International Criminal Court, *Prosecutor v. Bosco Ntaganda*, ICC-01/04-02/06-308, Pre-Trial Chamber II, [Decision on Admissibility of Evidence and Other Procedural Matters](#), 8 June 2014, para. 30.

<sup>40</sup> Vendimi i Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore, para. 71.

propagandistike. Në çështjen gjyqësore *Limaj*, Trupi Gjykses II konstatoi dhe pranoi se “komunikatat shërbenin pjesërisht për qëllime propagandistike”.<sup>41</sup>

20. Sa i përket autenticitetit, Trupi Gjykses vëren se të gjitha materialet janë marrë nga një libër i z. Elshani botuar nga “Zëri i Kosovës” në “Prishtinë”.<sup>42</sup> Të gjitha komunikatat e ribotuara atje janë botuar fillimisht nga “Zëri i Kosovës”, mbajnë datë (ose datën e botimit, ose datën e vënë nga Shtabi Qendror i UÇK-së/Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së), janë numërtuar dhe kanë të identifikuar dhe numrin rendor të gazetës. Gjithashtu, pesë prej komunikatave të ribotuara në këtë libër përputhen me komunikatat e botuara nga “Zëri i Kosovës” që trajtohen në paragrafët 37-50 në vijim.<sup>43</sup>

21. Trupi Gjykses është bindur gjithashtu se materialet IT-04-84 P00933.E, ET U016-2577-U016-2578, ET U016-2579-U016-2582, ET U016-2606-A-U016-2606-B, U016-2621-U016-2621-ET e rishikuar, IT-04-84 P00946.E, U016-2726-U016-2726-ET e rishikuar, U016-2757-U016-2757-EDT, ET U016-2762-U016-2762, U016-2775-U016-2775-ET dhe një pjesë e ET U016-2778-U016-2779-ës, të cilat nuk janë komunikata, janë autentike *prima facie* pasi që të gjitha janë ribotuar nga “Zëri i Kosovës”, “Gazeta Shqiptare”, “Rilindja” ose “Qendra për Informim e Kosovës”, kanë datën e shënuar, dhe tregues të tjerë të origjinës. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur lidhur me autenticitetin e këtyre dokumenteve *prima facie*.

22. Trupi Gjykses është bindur gjithashtu edhe për vlerën provuese *prima facie* të të gjitha komunikatave të ribotuara, konkretisht U016-2583-U016-2583-ET e

---

<sup>41</sup> TPNJ, *Prokurori kundër Fatmir Limajt dhe të tjerëve*, IT-03-66-T, Trial Chamber II, [Judgement](#) (Aktgjykim), 30 nëntor 2005, para. 216 (nuk përfshihet poshtëshënimi, shtohet theksimi); *Shih gjithashtu Prokurori kundër Fatmir Limajt dhe të tjerëve*, IT-04-84-T, Trial Chamber I, [Judgement](#) (Aktgjykim), 3 prill 2008, para. 88 dhe 472 (përmbledh dëshminë e dëshmitarit Jakup Krasniqi).

<sup>42</sup> *Shih* IT-04-84 P00934.E; Shtojcën 1 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materiali 1A; *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore.

<sup>43</sup> Trupi Gjykses vëren se përputhen versionet e mëposhtme të botuara në librin e z. Elshani dhe nga “Zëri i Kosovës”: (i) materialet 1O dhe 9 janë komunikata 28; (ii) materialet 1P dhe 10 janë komunikata 29; (iii) materialet 1R dhe 11 janë komunikata 30; dhe (iv) materialet 1S dhe 12 janë komunikata 32; dhe (v) materialet 1T dhe 13 janë komunikata 33.

rishikuar, U016-2588-U016-2589-ET e rishikuar, U016-2603-U016-2604-ET e rishikuar, U016-2609-U016-2609 ET e rishikuar, U016-2619-U016-2620-ET e rishikuar, U016-2625-U016-2625-ET e rishikuar, ET U016-2631-U016-2631, U016-2653-U016-2654-ET e rishikuar, U016-2666-U016-2666-ET e rishikuar, ET U016-2667-U016-2668, ET U016-2676-U016-2676, U016-2708-U016-2708-ET e rishikuar, U016-2710-U016-2710-ET, U016-2750-U016-2750-ET, U016-2751-U016-2752-ET, IT-04-84 P00953.E, IT-04-84bis P00147.E, U016-2781-U016-2782-ET, U016-2793-U016-2794-ET, dhe një pjesë të ET U016-2778-U016-2779-ës pasi ato kanë lidhje me faktet e paraqitura në paragrafin 18 më lart, mbështesin versionet e tjera të komunikatave, dhe/ose se përmbajtja e tyre ka tregues të përputhshmërisë së temave dhe qëndrimeve.

23. Trupi Gjykses është bindur gjithashtu edhe për vlerën provuese *prima facie* të materialeve të mëposhtme sa i përket njërit apo disa prej aspekteve të paraqitura më lart dhe/ose për faktin se këto materiale duket se shërbejnë si mbështetje për materiale të tjera të pranuar si provë në këtë pjesë të vendimit: IT-04-84 P00934.E, IT-04-84 P00933.E, U016-2621-U016-2621-ET e rishikuar, IT-04-84 P00946.E, U016-2726-U016-2726-ET e rishikuar, dhe ET U016-2762-U016-2762.<sup>44</sup>

24. Trupi Gjykses nuk është bindur lidhur me autenticitetin dhe/ose vlerën provuese *prima facie* të: (i) ET U016-2577-U016-2578-ës pasi ky material tregon vetëm se informacioni është marrë nga “media serbe” pa dhënë hollësi të mëtejshme;<sup>45</sup> (ii) ET U016-2579-U016-2582-shit, ET U016-2606-A-U016-2606-B dhe U016-2757-U016-2757-EDT pasi këto materiale kanë nevojë për kontekstualizim nga autori i tyre dhe/ose një dëshmitar i cili të mund të japë informata të tjera lidhur me burimin ose përmbajtjen e tyre;<sup>46</sup> dhe (iii) U016-2775-U016-2775-ET pasi

---

<sup>44</sup> Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1A, 1B, 1K, 1Q, 1U, 1C2.

<sup>45</sup> Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1C.

<sup>46</sup> Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1D, 1H, 1A2.

aty thuhet se informacioni buron nga “njerëz të paidentifikuar”.<sup>47</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk i pranon këto dokumente si prova jогоjore.

25. Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese e dokumenteve në paragrafët 22-23 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues ndaj të akuzuarve. Mbrojtja do të ketë mundësi ta kundërshtojë përmbajtjen e këtyre materialeve gjatë pyetjeve që do t’u bëjë dëshmitarëve përkatës.

26. Bazuar mbi sa më lart, Trupi Gjykses pranon si prova U016-2583-U016-2583-ET e rishikuar, U016-2588-U016-2589-ET e rishikuar, U016-2603-U016-2604-ET e rishikuar, U016-2609-U016-2609-ET e rishikuar, U016-2619-U016-2620-ET e rishikuar, U016-2625-U016-2625-ET e rishikuar, ET U016-2631-U016-2631, U016-2653-U016-2654-ET e rishikuar, U016-2666-U016-2666-ET e rishikuar, ET U016-2667-U016-2668, ET U016-2676-U016-2676, U016-2708-U016-2708-ET e rishikuar, U016-2710-U016-2710-ET, U016-2750-U016-2750-ET, U016-2751-U016-2752-ET, IT-04-84 P00953.E, IT-04-84bis P00147.E, U016-2781-U016-2782-ET, U016-2793-U016-2794-ET, ET U016-2778-U016-2779, IT-04-84 P00934.E, IT-04-84 P00933.E, U016-2621-U016-2621-ET e rishikuar, IT-04-84 P00946.E, U016-2726-U016-2726-ET e rishikuar dhe ET U016-2762-U016-2762 dhe nuk pranon si prova ET U016-2577-U016-2578, ET U016-2579-U016-2582, ET U016-2606-A-U016-2606-B, U016-2757-U016-2757-EDT dhe U016-2775-U016-2775-ET.

## 2. Materiali 2 në Shtojcën 1

27. U008-1602-U008-1636 (Materiali 2 në Shtojcën 1) përbëhet nga: (i) dy intervista të z. Krasniqi botuar nga “Koha Ditore”;<sup>48</sup> (ii) ribotimi, ose botimi, nga

---

<sup>47</sup> Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jогоjore, materiali 1D2.

<sup>48</sup> U003-8552-U003-8690 (f. U003-8580-U003-8585, U003-8586-U003-8590); Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jогоjore, materialet 2A, 2B.

“Koha Ditore” i komunikatave 35, 46, 49, 53, 55, 57-58, 62, 71;<sup>49</sup> (iii) ribotimi, ose botimi, nga “Bujku” i komunikatave 40-43, 45, 64;<sup>50</sup> (iv) një artikull me titull “UÇK i Dërgon Memorandum Bashkësisë Ndërkombëtare”, ribotuar nga “Koha Ditore” më 17 tetor 1998;<sup>51</sup> (v) deklarata nr. 3 e Drejtorisë së Policisë Ushtarake të UÇK-së dhe deklaratat politike 8, 16-17, 19 të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, të botuara nga “Koha Ditore”;<sup>52</sup> (vi) një artikull me titull “UÇK-ja arrestoi një grup banditësh dhe bashkëpunëtorësh”, botuar nga “Bujku” më 23 nëntor 1998;<sup>53</sup> (vii) deklarata politike 3, e cila përfshin gjithashtu edhe një shkrim mbi një deklaratë të Ministrisë së Financave me titull “Beteja për Pavarësi duhet Përkrahur edhe Financiarisht”;<sup>54</sup> (viii) deklarata politike 8 botuar nga “Bujku”;<sup>55</sup> (ix) deklarata politike 4 dhe një artikull me titull “Në UÇK nuk ka Brigadë të Parë dhe kjo Është Inekzistente”, botuar nga “Zëri i Kosovës”;<sup>56</sup> (x) një deklaratë e Përfaqësuesit të Përgjithshëm Politik të UÇK-së për lirimin e Milovan Stankoviçit nga arresti dhe deklarata politike 11 e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së botuar nga “Koha Ditore” më 8 qershor 1998;<sup>57</sup> dhe (xi) deklaratat e Adem Demaçit botuar nga “Koha Ditore” më 14 tetor 1998.<sup>58</sup>

<sup>49</sup> U008-1607-U008-1607-ET, U003-8552-U003-8690 (f. U003-8571-U003-8571, U003-8611-U003-8612, U003-8660-U003-8660), U008-1615-U008-1615-ET, U008-1616-U008-1616-ET, U008-1618-U008-1618-ET, U008-1620-U008-1620-ET, U008-1624-U008-1624-ET e rishikuar; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materialet 2C, 2I, 2K, 2L 2N, 2O, 2P, 2T, 2X.

<sup>50</sup> U008-1608-U008-1608-ET e rishikuar, U008-1609-U008-1609-ET e rishikuar, U008-1610-U008-1610-ET, U008-1611-U008-1611-ET, U003-8552-U003-8690 (f. U003-8566-U003-8567), U008-1628-U008-1628-ET e rishikuar; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materialet 2D, 2E, 2F, 2G, 2H, 2W. Trupi Gjykses vëren se komunikatat 47 dhe 54 janë pranuar si prova përmes Vendimit të Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore; *Shih* Vendimin e Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore, para. 69-77.

<sup>51</sup> U003-8552-U003-8690 (f. U003-8623-U003-8624); Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 2Q.

<sup>52</sup> U008-1622-U008-1622-ET.02, U008-1623-U008-1623-ET, U008-1627-U008-1627-ET e rishikuar, U008-1633-U008-1633-ET; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materialet 2R, 2S, 2V, 2B2.

<sup>53</sup> U008-1625-U008-1625-ET; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 2U.

<sup>54</sup> U008-1630-U008-1630-ET e rishikuar; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 2Y.

<sup>55</sup> U008-1632-U008-1632-ET; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 2A2.

<sup>56</sup> SPOE00209433-SPOE00209433-ET e rishikuar 1; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 2Z.

<sup>57</sup> U008-1634-U008-1634-ET; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 2C2

<sup>58</sup> U008-1635-U008-1635-ET e rishikuar; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 2D2.



28. Trupi Gjykues është i mendimit se komunikatat me të njëjtin numërtim si ato që janë paraqitur në materialet 1 dhe 4-69 të Shtojcës 1, por të botuara nga një organ tjetër lajmesh kanë lidhje me një a më shumë prej aspekteve që janë trajtuar në paragrafët 18 dhe 38. Si të tilla, është provuar se kanë lidhje me këtë çështje gjyqësore. Për më tepër, për arsyet e përshkruara më lart, Trupi Gjykues është i gatshëm të pranojë si prova disa versione të së njëjtës komunikatë, edhe në rastet kur informacioni që përmbahet është i njëjtë. Fakti se e njëjta komunikatë është botuar nga disa organe të medias rreth së njëjtës kohë, pa ndryshim të thelbit të saj apo me ndryshime të parëndësishme, vërteton ekzistencën e saj dhe, në një farë mase, edhe burimin.<sup>59</sup> Një gjë e tillë është edhe njëfarë treguesi i autenticitetit.

29. Gjithashtu, Trupi Gjykues konstaton se materialet e tjera që mbeten kanë lidhje me: (i) shkallën e organizimit të UÇK-së dhe aspektin e ndërlidhur të pretendimit të ekzistencës së një konflikti të armatosur jondërkombëtar; (ii) përpjekjet për krijimin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së si i vetmi zë i ligjshëm i popullit shqiptar të Kosovës; dhe (iii) aspektet e strukturës komanduese dhe të autoritetit të UÇK-së dhe të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.<sup>60</sup> Trupi Gjykues vëren se disa prej këtyre materialeve mbajnë datë që del nga kuadri kohor i periudhës së Aktakuzës dhe i juridiksionit kohor të DHS-së, por konsideron, sidoqoftë, se këto materiale janë relevante për arsyet e përshkruara në paragrafin 18 më lart.<sup>61</sup>

30. Sa i përket autenticitetit, Trupi Gjykues është bindur lidhur me autenticitetin e këtyre materialeve *prima facie*. Të gjitha materialet janë botuar fillimisht, ose ribotuar, nga “Koha Ditore”, “Bujku”, ose “Zëri i Kosovës”, ZPS-ja ka dhënë datat e botimit, dhe këto materiale kanë të gjithë treguesit përkatës të burimit të tyre. Lidhur me komunikatat e botuara, ose ribotuara, nga “Koha Ditore” dhe “Bujku”,

---

<sup>59</sup> *Shih më lart e më poshtë*, para. 17-26, 37-50.

<sup>60</sup> Aktakuza e Ndryshuar, para. 18, 36-37.

<sup>61</sup> *Shih më lart*, poshtëshënimi. 39.

Trupi Gjykses vëren se komunikatat dhe deklaratat politike përgjithësisht përputhen në përmbajtje me versionet e botuara nga “Zëri i Kosovës”, dhe që trajtohen më lart në paragrafët 17-26, më poshtë në paragrafët 37-50, ose të cilat janë pranuar tashmë si prova.<sup>62</sup>

31. Sa i përket vlerës provuese *prima facie*, Trupi Gjykses është i mendimit se të gjitha komunikatat e botuara, ose të ribotuara, nga “Koha Ditore” dhe “Bujku” kanë vlerë provuese *prima facie*, pasi mbështesin versionet e tjera të komunikatave, dhe se përmbajtja e tyre ka tregues të përputhshmërisë së temave dhe qëndrimeve.<sup>63</sup> Përmbajtja e tyre ka gjasa të jetë provuese sa u përket disa aspekteve që kanë lidhje me këtë çështje gjyqësore siç është treguar më lart në paragrafët 28-29.

32. Gjithashtu, Trupi Gjykses është bindur se deklarata nr. 3 që i atribuohet Drejtorisë së Policisë Ushtarake të UÇK-së (U008-1622-U008-1622-ET.02), deklaratat politike 3, 4, 8, 11, 16-17, dhe 19 (U008-1622-U008-1622-ET.02, U008-1623-U008-1623-ET, U008-1627-U008-1627-ET e rishikuar, SPOE00209433-SPOE00209433-ET e rishikuar 1, U008-1630-U008-1630-ET e rishikuar, U008-1633-U008-1633-ET, dhe U008-1634-U008-1634-ET) dhe deklarata politike 8 (U008-1632-U008-1632-ET) kanë vlerë provuese *prima facie*.<sup>64</sup> Ato janë deklarata të botuara në emër të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, janë relevante për sa i përket vërtetimit

---

<sup>62</sup> Ndër të tjera, Trupi Gjykses vëren se përputhen versionet e mëposhtme të botuara nga “Koha Ditore” dhe “Bujku” me versionet e “Zërit të Kosovës” të ribotuara në librin e z. Elshani: (i) materialet 2C dhe 15 janë komunikata 35; (ii) materialet 1B2 dhe 2D janë komunikata 40; (iii) materialet 1E2 dhe 2E janë komunikata 41; (iv) materialet 1G2, 2F dhe 21 janë komunikata 42; (v) materialet 2G dhe 20 janë komunikata 43; (vi) materialet 1H2, 2H dhe 22 janë komunikata 44; (vii) materialet 2H dhe 22 janë komunikata 45; (viii) materialet 1I2, 2I dhe 23 janë komunikata 46; (ix) materialet 2K dhe 26 janë komunikata 49; (x) materiali 2L dhe P00157 janë komunikata 53; (xi) materialet 2N dhe 39 janë komunikata 55; (xii) materialet 2P dhe 42 janë komunikata 58; (xiii) materialet 2Y dhe 63 janë deklarata politike 3; (xiv) materiali 2A2 dhe P00174 janë deklarata politike 9; (xv) materialet 2C2 dhe 41 janë deklarata politike 11; (xvi) materiali 2R dhe P00159 janë deklarata politike 16; dhe (xvii) materialet 2S dhe 54 janë deklarata politike 17.

<sup>63</sup> *Shih më lart e më poshtë*, poshtëshënimet. 62, 103.

<sup>64</sup> Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materialet 2R, 2S, 2V, 2Y, 2Z, 2A2, 2B2, 2C2.

të fakteve dhe rrethanave të kësaj çështjeje gjyqësore, siç është treguar më lart në paragrafin 29. Për më tepër, përmbajtja e disa prej këtyre deklaratave mbështet deklaratat e tjera, gjë që u shton vlerën provuese *prima facie*. Për shembull, Trupi Gjyqësor vëren se: (i) komunikata 62 (U008-1624-U008-1624-ET e rishikuar) dhe deklaratat politike 16 dhe 19 (U008-1622-U008-1622-ET.02 dhe U008-1627-U008-1627-ET e rishikuar) i referohen angazhimit të UÇK-së për “vetëpërmbajtje”, ose për një “armëpushim” që është njoftuar fillimisht me anë të deklaratës politike 12 e cila është trajtuar në paragrafët 37-50 në vijim;<sup>65</sup> dhe (ii) deklarata e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së me titull “Në UÇK nuk ka Brigadë të Parë, Ajo është Inekzistente” në SPOE00209433-SPOE00209433-ET e rishikuar 1 mbështet ekzistencën dhe përmbajtjen e deklaratës politike nr. 4 pasi aty thuhet “qëndrimi i UÇK-së është ai që shprehet në Deklaratën Politike Nr. 4”.<sup>66</sup> Në fund, Trupi Gjyqësor është bindur gjithashtu edhe lidhur me vlerën provuese *prima facie* të U008-1634-U008-1634-ET.<sup>67</sup> Dëshmitari i ZPS-së W03540 e ka komentuar këtë dokument. Megjithëse ai konfirmoi përmbajtjen e dokumentit në përgjithësi, burimin dhe datën e tij, ai nuk ishte dakord me faktin se sa të vërteta ishin disa nga pretendimet që përmban ky dokument.<sup>68</sup> Këto pretendime, si dhe lidhja e tyre me çështjen gjyqësore, do të trajtohen në vijimësi të këtij procesi dhe nuk ndikojnë mbi pranueshmërinë e dokumentit si provë. Megjithatë, Trupi Gjyqësor është i mendimit se materiali ka vlerë provuese *prima facie* sa i përket arrestimit dhe ndalimit të W03540-s, rrethanave në të cilat ka ndodhur një gjë e tillë, autoritetit përgjegjës, si dhe procesit të lirimit të të ndaluarve.<sup>69</sup>

---

<sup>65</sup> Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materialet 2R, 2T, 2V; *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Mocionit për Pranimin e Provave Jogojore, materiali 45.

<sup>66</sup> Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 2Z.

<sup>67</sup> Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 2C2.

<sup>68</sup> Transkript i Seancës, 19 qershor 2023, f. 5077, rreshti 20 deri f. 5080, rreshti 9,

<sup>69</sup> U008-1634-U008-1634-ET; *Shih gjithashtu* Transkriptin e Seancës, 19 qershor 2023, f. 5078, rreshti 10 deri f. 5080, rreshti 9.

33. Në këtë pikë, Trupi Gjykses nuk është bindur se ZPS-ja ka vërtetuar vlerën provuese *prima facie* të materialeve në vijim: (i) U003-8580-U003-8585 dhe U003-8586-U003-8590 (që përfshihet në U003-8552-U003-8690-n) pasi pranimi i tyre, në këtë fazë, në mungesë të kontekstit më të gjerë, do të krijonte probleme të ballafaqimit dhe të dëmit ndaj të akuzuarve;<sup>70</sup> (ii) U003-8623-U003-8624 (që përfshihet në U003-8552-U003-8690-n) pasi nuk është i qartë se cili është burimi i informacionit që përmban dhe që është kryesisht i natyrës historike;<sup>71</sup> (iii) U008-1625-U008-1625-ET pasi nuk është e qartë se cili është burimi i informacionit të këtij materiali dhe, për këtë arsye, do të ishte me vlerë konteksti i mëtejshëm që paraqitet përmes një dëshmitari;<sup>72</sup> dhe (iv) U008-1635-U008-1635-ET e rishikuar pasi ky material ka nevojë për kontekst të mëtejshëm që paraqitet përmes një dëshmitari.<sup>73</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk i pranon këto dokumente si prova jogojore në këtë fazë të procesit.

34. Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese e dokumenteve në paragrafët 31-32 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues ndaj të akuzuarve. Mbrojtja do të ketë mundësi ta kundërshtojë përmbajtjen e këtyre materialeve gjatë pyetjeve që do t'u bëjë dëshmitarëve përkatës.

35. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses pranon si prova U008-1607-U008-1607-ET, U008-1608-U008-1608-ET e rishikuar, U008-1609-U008-1609-ET e rishikuar, U008-1610-U008-1610-ET, U008-1611-U008-1611-ET, U003-8552-U003-8690 (f. U003-8566-U003-8567, U003-8571-U003-8571, U003-8611-U003-8612, U003-8660-U003-8660), U008-1615-U008-1615-ET, U008-1616-U008-1616-ET, U008-1618-U008-1618-ET, U008-1620-U008-1620-ET, U008-1622-U008-1622-ET.02, U008-1623-U008-1623-ET, U008-1624-U008-1624-ET e rishikuar, U008-1627-U008-1627-ET e rishikuar, U008-1628-U008-1628-ET e rishikuar, U008-1630-U008-1630-ET e

---

<sup>70</sup> Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materialet 2A, 2B.

<sup>71</sup> Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 2Q.

<sup>72</sup> Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 2U.

<sup>73</sup> Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 2D2.

rishikuar, SPOE00209433-SPOE00209433-ET e rishikuar 1, U008-1632-U008-1632-ET, U008-1633-U008-1633-ET, dhe U008-1634-U008-1634-ET dhe nuk pranon U003-8552-U003-8690 (f. U003-8580-U003-8585, U003-8586-U003-8590 dhe U003-8623-U003-8624), U008-1625-U008-1625-ET dhe U008-1635-U008-1635-ET e rishikuar.

### 3. Materiali 3 në Shtojcën 1

36. U003-8552-U003-8690 (Materiali 3 në Shtojcën 1) është përzgjedhje e disa komunikatave dhe deklarimeve publike të UÇK-së që janë marrë nga Shërbimi i Informacionit për Transmetimet e Huaja ("FBIS"). Trupi Gjykses vëren, sidoqoftë, se ZPS-ja nuk ka bërë parashtrime për lidhjen me lëndën gjyqësore, autenticitetin dhe vlerën provuese të materialeve që përfshihen aty, apo lidhur me grupin e përzgjedhur të dokumenteve në tërësi. Trupi Gjykses vëren se disa prej dokumenteve në këtë material janë versione të përkthyer të dokumenteve të ribotuar nga FBIS-i të cilat janë përfshirë edhe në pjesë të tjera të Mocionit të Provave Jogojore. Megjithatë, Trupi Gjykses vëren se jo të gjitha dokumentet e U003-8552-U003-8690-s janë përfshirë në pjesë të tjera të Mocionit të Provave Jogojore, dhe disa paraqiten për herë të parë përmes U003-8552-U003-8690-s. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk ka marrë parashtrime mbi këto dokumente që t'i shqyrtojë për të verifikuar nëse përmbushen kushtet për pranimin e tyre si prova. Për më tepër, ZPS-ja nuk ka shpjeguar në hollësi se në ç'mënyrë lidhet me lëndën e kësaj çështjeje gjyqësore ribotimi nga FBIS-i i materialeve, si për shembull i komunikatave. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se disa faqe të U003-8552-U003-8690-s ZPS-ja i ka paraqitur herë si përkthime të disa pjesëve nga Materiali 2 herë si përkthime të disa prej Materialeve 4-69 të Shtojcës 1. ZPS-ja nuk ka paraqitur referenca të ndonjë materiali të U003-8552-U003-8690-s që përkon me materiale të tjera të Shtojcës 1. Si pasojë, duket se ZPS-ja i paraqet dokumente të tilla dy herë përmes Mocionit të Provave Jogojore. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses e refuzon jo në

formë të prerë pranimin e U003-8552-U003-8690-n si provë jogojore, me përjashtim të atyre faqeve që janë pranuar si përkthime të materialeve të tjera të Shtojcës 1. Po të dëshirojë, ZPS-ja mund të bëjë një kërkesë të re për pranimin e pjesëve që mbeten nga U003-8552-U003-8690, me kusht që të faktohet si duhet dhe të tregohet lidhja e referencës me materialet e pranuar tashmë.

#### 4. Materialet 4-69 në Shtojcën 1

37. Materialet që mbeten nga Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore përfshijnë: (i) një shënim me shkrim dore në serbisht drejtuar ekipit redaksional të gazetës “Jedinstvo” dërguar nga IRJ e Maqedonisë;<sup>74</sup> (ii) komunikatat 18-19, 24, 28-30, 32-33, 35-36, 38-40,<sup>75</sup> 42-46,<sup>76</sup> 48-49, 51-52,<sup>77</sup> 55, 57-58, 61,<sup>78</sup> 65,<sup>79</sup> 66-67,<sup>80</sup> 68-69,<sup>81</sup> dhe 70 të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, botuar nga “Zëri i Kosovës” (komunikatat 37, 53-54, dhe 59-60 janë pranuar si prova me anë të Vendimit të Dytë mbi Pranimin e Provave Jogojore);<sup>82</sup> (iii) komunikatat 62 dhe 64, botuar nga “Koha

<sup>74</sup> U000-0341-U000-0341; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 4.

<sup>75</sup> Trupi Gjykses vëren se SPOE00209302-00209302 nuk ka numër të komunikatës por thekson se përmbajtja është e ngjashme me U016-2760-U016-2761-EDT që është trajtuar më lart, dhe që është komunikata 40; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1B2, 19.

<sup>76</sup> Trupi Gjykses vëren se SPOE40000792-SPOE40000792-ET e rishikuar 2 përmban edhe një deklaratë me titull “Kurthet e Cinizmit të (Dez)Informimit të TVSH-së”; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 22.

<sup>77</sup> Trupi Gjykses vëren se 043801-043801 përmban edhe një artikull me titull “Mahmuti: “UÇK-ja deri më Tashti Nuk ka Vrarë Asnjë Civil”; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 34.

<sup>78</sup> Trupi Gjykses vëren se 043862-043862 përmban edhe një raport nga Zona Operative e Dukagjinit si dhe një shënim informues nga Drejtoria për Informim; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 53.

<sup>79</sup> Trupi Gjykses vëren se SPOE40000799-40000799 përmban edhe dy shënime informuese nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 57.

<sup>80</sup> Trupi Gjykses vëren se SPOE40000796-40000796 përmban një deklaratë për shtyp dhe një shënim informues nga Drejtoria për Informim e UÇK-së; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 58A.

<sup>81</sup> Trupi Gjykses vëren se SPOE00056435-SPOE00056435 përmban edhe një deklaratë të Shaban Sinanit me titull “Cili do të Jetë “Zëri i Vetëm” i Kosovës?”; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 59.

<sup>82</sup> 074573-074573, 074575-074575, 074579-074579, SPOE00209303-00209303, SPOE00209304-00209304, SPOE00209305-00209305, SPOE00209306-00209306, SPOE00209307-00209307, SPOE00209308-00209308,



Ditore" dhe komunikata 66, botuar nga "Kosovasot";<sup>83</sup> (iv) një artikull me titull "Aksione të Reja të UÇK-së", ku përmbledhen komunikatat 21-23 botuar fillimisht nga "Zëri i Kosovës" më 25 prill 1996;<sup>84</sup> (v) një shkrim me titull "Fjala e Ushtarëve të UÇK-së në Varrimin e Mësuesit Halil Geci në Llaushë. Vëllezër e motra, nëna dhe baballarë, të afërm të vëllait tonë Halil Gecaj!", botuar nga "Zëri i Kosovës" më 11 dhjetor 1997;<sup>85</sup> (vi) deklaratat politike 2,<sup>86</sup> 3, 5-7, 11-12, 13,<sup>87</sup> 14, 17,<sup>88</sup> 20, 21, 22 (deklaratat politike 9-10 janë pranuar si prova me anë të Vendimit të Dytë mbi Pranimin e Provave Jogojore), botuar nga "Bujku", "Zëri i Kosovës" dhe/ose "Koha Ditore";<sup>89</sup> (vii) botimin nga "Bujku" të deklaratës politike 5, të prezantuar në televizionin shqiptar nga z. Krasniqi;<sup>90</sup> (viii) artikujt e botuar në *Agence France Presse* dhe në *BBC* përkatësisht, ku pasqyrohet deklarata politike 7;<sup>91</sup> (ix) një shkrim nga "Zëri i Kosovës" më 3 shtator 1998, që përmban një prononcim të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së i cili i atribuohet Shtabit të Përgjithshëm të

---

SPOE00209309-00209309, SPOE00209311-00209311, SPOE00209312-00209312, SPOE00209302-00209302, SPOE00209429-00209429, SPOE40000792-40000792, SPOE00209430-00209430, SPOE40000793-40000793, SPOE00209431-00209431, 043801-043801, 043804-043804, 043806-043806, 043862-043862, 043807-043807, SPOE40000799-40000799, SPOE40000796-40000796, SPOE00056435-SPOE00056435, SPOE00056467-SPOE00056467, SPOE00056419-SPOE00056419; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materialet 5-6, 8-15, 17-19, 21-23, 25-26, 34, 39, 41-42, 53, 57, 58A, 59-60, 64; *Shih gjithashtu* Vendimin e Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore, para. 69-77, 145-153.

<sup>83</sup> SPOE00199239-SPOE00199240, U000-0519-U000-0519 dhe U008-1668-U008-1668; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materialet 55-56, 58.

<sup>84</sup> 074577-074577; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 7.

<sup>85</sup> SPOE00209301-00209301; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 20.

<sup>86</sup> Trupi Gjykses vëren se dokumenti ka titullin "komunikatë" por se mbi këtë dokument është shkruar me dorë "deklarata politike nr. 2"; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 24A.

<sup>87</sup> Trupi Gjykses vëren se ekzistojnë dy versione të deklaratës politike 13, konkretisht 043808-043808 (botuar nga "Zëri i Kosovës") dhe U000-9943-U000-9943 (botuar nga "Koha Ditore"); Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materialet 45, 45A.

<sup>88</sup> Trupi Gjykses vëren se 043864-043864 përfshin edhe dy shënime informuese nga Drejtoria për Informim e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 54.

<sup>89</sup> U016-2148-U016-2148, 043850-043850, 043852-043852, U000-8992-U000-8992, 043806-043806, 043808-043808, U000-9943-U000-9943, 043860-043860, 043865-043865, 043864-043864, SPOE40000799-40000799, SPOE40000798-40000798, SPOE00209432-00209432, SPOE00056419-SPOE00056419; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materialet 24A, 28-29, 30, 41, 45, 45A, 50, 52, 54, 57, 61, 63-64; *Shih gjithashtu* Vendimin e Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore, para. 69-77, 145-153.

<sup>90</sup> SPOE00199392-00199394; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 28A.

<sup>91</sup> 019582-019583, 019584-019585; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materialet 30A, 30B.

UÇK-së dhe titullohet “Gënjeshtër e Okupatorit Serb për Gjoja Ekzistimin e një Varreze Kolektive të Qytetarëve Serbë në Fshatin Kleçkë” dhe një intervistë me Fatmir Limajn;<sup>92</sup> (x) përkthime nga FBIS-i të komunikatës 51, të cilën z. Krasniqi ia dha fillimisht TVSH-së më 26 gusht 1998, të komunikatës 59 si dhe të një komunikate nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së të datës 18 gusht 1999 nënshkruar nga Agim Çeku;<sup>93</sup> (xi) ribotimin e komunikatës 59 nga “Bota e Re”;<sup>94</sup> (xii) deklaratat 3 dhe 4 të Drejtorisë së Policisë Ushtarake, botuar nga “Zëri i Kosovës”, si dhe një version tjetër të deklaratës 4, botuar nga “Koha Ditore”;<sup>95</sup> (xiii) një deklaratë publike që i atribuohet z. Thaçi, si shef i Drejtorisë Politike të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, me titull “Ftojme të Hamendurit që të Ndërgjegjësohen dhe të Largohen nga Veprimet Esadiste të ‘Qeverisë’”, botuar nga “Zëri i Kosovës” më 28 janar 1999 (ky material përfshin edhe komunikatën 70);<sup>96</sup> dhe (xiv) komunikatën 80 të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së botuar nga *Kosovapress*.<sup>97</sup>

38. Trupi Gjykes është bindur se këto materiale kanë lidhje me lëndën pasi kanë të bëjnë me: (i) pretendimin se UÇK-ja ka shfrytëzuar që në një fazë të hershme veprimet ushtarake, komunikatat dhe deklaratat politike; (ii) ekzistencën e konfliktit të armatosur, elementeve përbërëse (përfshirë aftësitë organizative të UÇK-së) dhe llojin e tij; (iii) marrëdhëniet ndërmjet LPK-së dhe UÇK-së; (iv) pretendimin se Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së ka pasur dijeni dhe ka mbikëqyrur operacionet ushtarake; (v) pretendimin se Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së ka pasur aftësi t’u lëshojë urdhra operativë forcave të UÇK-së dhe se ka

---

<sup>92</sup> 043855-043856; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 33.

<sup>93</sup> IT-03-66 P138, SPOE00199229-SPOE00199230, SITF00172935-00172935; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 34A, 46, 69.

<sup>94</sup> U008-1667-U008-1667; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 43A.

<sup>95</sup> 043857-043858, 043862-043862 dhe IT-03-66 P146; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materialet 49, 53, 53A.

<sup>96</sup> SPOE00056467-SPOE00056467; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 60.

<sup>97</sup> SPOE00313999-00313999; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 68.

luajtur rol operativ; (vi) pretendimin për politikën e vënies në shënjestër të “bashkëpunëtorëve” dhe të justifikimit të sulmeve kundër tyre; (vii) ekzistencën dhe rolin e Drejtorisë së Policisë Ushtarake të UÇK-së; (viii) zbatimin e Rezolutës 1199 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara; (ix) krimeve që pretendohet të jenë kryer në Drenoc; dhe (x) pretendimeve lidhur me organizimin dhe kontrollin e mediave nga ana e UÇK-së.<sup>98</sup>

39. Sa i përket autenticitetit, Trupi Gjykses është bindur lidhur me autenticitetin e SPOE00209303-00209303-it, SPOE00209304-00209304-ës, SPOE00209305-00209305-ës, SPOE00209306-00209306-ës, SPOE00209307-00209307-ës, SPOE00209308-00209308-ës, SPOE00209309-00209309-ës, SPOE00209311-00209311-ës, SPOE00209312-00209312-ës, SPOE00209302-00209302-ës, SPOE00209429-00209429-ës, SPOE40000792-40000792-it, SPOE00209430-00209430-s, U016-2148-U016-2148-ës, SPOE40000793-40000793-it, SPOE00209431-00209431-it, 043850-043850-s, SPOE00199392-00199394-ës, 043852-043852-it, 043801-043801-it, IT-03-66 P138-ës, 043804-043804-ës, 043806-043806-ës, 043807-043807-ës, U008-1667-U008-1667-ës, 043808-043808-ës, SPOE00199229-SPOE00199230-s, 043860-043860-s, 043865-043865-ës, 043862-043862-it, 043864-043864-ës, SPOE40000799-40000799-ës, U008-1668-U008-1668-ës, SPOE40000796-40000796-ës, SPOE00056435-SPOE00056435-ës, SPOE00056467-SPOE00056467-ës, SPOE40000798-40000798-ës, SPOE00209432-00209432-it, dhe SPOE00056419-SPOE00056419-ës, të cilat janë komunikata dhe deklarata politike të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.<sup>99</sup> Të gjitha komunikatat janë botuar nga “Zëri i Kosovës”, me përjashtim të pesë rasteve kur komunikatat (komunikatat 55, 59, 62 dhe 66) janë botuar nga “Koha Ditore”, “Bota e Re” ose “Kosova Sot”, ose ribotuar nga

<sup>98</sup> Aktakuza e Ndryshuar, para. 18, 23, 36, 39, 149.

<sup>99</sup> Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materialet 9-15, 17-19, 21-23, 24A, 25-26, 28, 28A, 29, 34, 34A, 39, 41-42, 43A, 45-46, 50, 52, 53-54, 57-58, 58A, 59-61, 63-64.

FBIS-i që i ka marrë nga këto organe.<sup>100</sup> Shumë prej tyre janë botuar po ashtu edhe në gazeta të tjera si “Bujku” dhe “Koha Ditore”.<sup>101</sup> Të gjitha deklaratat politike janë botuar nga “Bujku”, “Zëri i Kosovës” ose “Koha Ditore” dhe disa prej tyre janë botuar nga disa prej këtyre gazetave. Të gjitha komunikatat dhe deklaratat/deklarimet politike, me tre përjashtime,<sup>102</sup> mbajnë edhe datën e shënuar nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së edhe datën e botimit. Të tre këto materiale mbajnë numër si dhe numrin e tirazhit të gazetës. Trupi Gjykses vëren se është e mundur që këto deklarata të shihen brenda kontekstit të gamës së komunikatave dhe deklaratave që ka paraqitur për pranim si prova ZPS-ja. Ato mbajnë shenja të burimit nga pretendohet se kanë ardhur. Përmbajtja dhe formulimet e shumë prej këtyre materialeve mbështeten po ashtu edhe nga materialet e tjera që janë ofruar për pranim përmes Mocionit të Provave Jogojore ose të atyre të pranuar tashmë si prova.<sup>103</sup> Së fundi, Trupi Gjykses vëren se asnjëra nga komunikatat dhe deklaratat politike nuk ka nënshkrim apo vulë, gjë që bie në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes se mungesa e nënshkrimit minon pretendimin se këto dokumente janë autentike.

40. Gjithashtu, Trupi Gjykses është bindur edhe lidhur me autenticitetin *prima facie* të deklaratave të lëshuara nga Drejtoria e Policisë Ushtarake (043857-043858, një pjesë e 043862-043862-it dhe IT-03-66 P146-ës). Ato janë botuar në një gazetë,

---

<sup>100</sup> Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materialet 39A, 43A, 46, 55, 58.

<sup>101</sup> *Shih me lart*, poshtëshënimi. 62.

<sup>102</sup> Trupi Gjykses vëren se: (i) SPOE00209308-00209308 dhe SPOE00209431-00209431 nuk kanë datë të shënuar nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së por të dyja mbajnë datën e botimit; dhe (ii) 043865-043865 nuk ka datë botimi po mban datën e shënuar nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së; Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materialet 14, 26, 52.

<sup>103</sup> Trupi Gjykses vëren se materialet vijuese, ndër të tjera, mbështesin njëri-tjetrin: (i) materiali 1K konfirmon komunikatën 21 (materiali 1J); (ii) komunikata 28 (materialet 1O, 9) konfirmojnë komunikatën 27 (materiali 1N); (iii) komunikata 32 (materialet 1S, 13) përdor gjuhë të ngjashme me komunikatat 28-30 (materialet 1O, 1P, 1R, 9-11); (iv) komunikata 46 (materialet 1I2, 23) konfirmon komunikatën 45 (Materialet 2H, 22); (v) komunikatat 58, 62, 66 (materialet 2P, 2T, 42, 58, 58A) dhe deklaratat politike 16, 18-19, 21-22 (materialet 2R, 2V, 52, 57, 64) konfirmojnë deklaratën politike 12 (materiali 45); dhe (vi) deklarata politike 19 (materiali 2V) konfirmon deklaratën politike 18 (materiali 52)

pretendohet se burojnë nga Drejtoria e Policisë Ushtarake, mbajnë datë, dhe përmbajnë informacion që lidhet me faktet e konfirmuara përmes dokumenteve të tjera.

41. Trupi Gjykses është bindur edhe lidhur me autenticitetin *prima facie* të SPOE00209301-00209301-shit, 019582-019583-shit, 019584-019585, dhe 043855-043856-ës pasi ato janë botuar përkatësisht nga “Zëri i Kosovës”, “Koha Ditore”, *Agence France Presse*, ose nga BBC-ja dhe kanë datën e shënuar.<sup>104</sup> Gjithashtu, nuk ka tregues që të kundërshtojë autenticitetin e tyre.

42. Trupi Gjykses nuk është bindur se ZPS-ja ka vërtetuar autenticitetin *prima facie* të materialeve në vijim: U000-0341-U000-0341, 074573-074573, 074575-074575, 074577-074577, 074579-074579, U000-9943-U000-9943, U000-8992-U000-8992, U000-0519-U000-0519, SPOE00199239-SPOE00199240, SITF00172935-00172935, dhe SPOE00313999-00313999.<sup>105</sup> Së pari, sa i përket U000-0341-U000-0341-shit, Trupi Gjykses është i mendimit se: (i) nuk ka tregues që ky dokument të jetë botuar siç janë botuar komunikatat e tjera; (ii) nuk ka tregues se kush është autori i shënimit me shkrim dore në këtë dokument; dhe (iii) dokumenti nuk përmban tregues të tjerë që do t’i mundësonin Trupit Gjykses të verifikonte autenticitetin e tij *prima facie*.<sup>106</sup> Së dyti, sa u përket 074573-074573-shit, 074575-074575-ës, 074577-074577-ës, 074579-074579-ës, U000-9943-U000-9943-shit, U000-8992-U000-8992-shit dhe U000-0519-U000-0519-ës, Trupi Gjykses vëren se fotokopjet e këtyre artikujve nuk tregojnë vendin dhe kohën e botimit.<sup>107</sup> Pala që paraqet dokumentet për pranim si provë mban përgjegjësinë të përmbushë kushtet e pranueshmërisë së dokumenteve të ofruara me qëllim që t’i mundësojë Trupit Gjykses të verifikojë përmbushjen apo jo të këtyre kushteve. Së treti, sa u përket SITF00172935-

---

<sup>104</sup> Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materialet 20, 30A, 30B, 33, 68.

<sup>105</sup> Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materialet 4-8, 30, 45A, 55-56, 68-69.

<sup>106</sup> Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 4.

<sup>107</sup> Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materialet 5-8, 30, 45A, 56.

00172935-ës dhe SPOE00199239-SPOE00199240-s, Trupi Gjykses vë në dukje se ZPS-ja ka dorëzuar vetëm përkthimet e komunikatave por jo versionet origjinale.<sup>108</sup> Së katërti, sa i përket SPOE00313999-00313999-ës, Trupi Gjykses vë në dukje se ky material nuk ka treguesit e zakonshëm të cilët do t'i mundësonin Trupi Gjykses të verifikonte autenticitetin e tij *prima facie*. Në këtë mënyrë, Trupi Gjykses nuk është në gjendje të verifikojë kushtet e pranueshmërisë së këtyre dy materialeve. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk i pranon këto dokumente si prova jогоjore.

43. Sa i përket vlerës provuese *prima facie*, Trupi Gjykses është bindur se ZPS-ja ka vërtetuar vlerën provuese *prima facie* të komunikatave dhe deklaratave politike të diskutuara më lart. Trupi Gjykses vëren se komunikatat dhe deklaratat politike janë botuar në emër të Shtabit Qendror të UÇK-së, ose Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, dhe mund të jenë relevante për vërtetimin e fakteve dhe rrethanave që lidhen me këtë çështje gjyqësore, siç është përshkruar në paragrafin 38. Shumë prej komunikatave dhe deklaratave politike janë botuar gjerësisht në disa gazeta të ndryshme.<sup>109</sup> UÇK-ja nuk ka kundërshtuar autorësinë apo përmbajtjen e tyre gjatë periudhës përkatëse. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se shumë prej komunikatave ose deklaratave politike mbështesin njëra-tjetrën.<sup>110</sup> Siç është konstatuar në Vendimin e Dytë mbi Mocionin e Provave Jогоjore, fakti se një prej synimeve ishte që komunikatat të ishin propagandistike apo të fryra nuk i bën të papranueshme si prova,<sup>111</sup> as nuk mohon se ato kanë shërbyer edhe për synime të tjera. Trupi Gjykses do të përcaktojë, mbi bazën e të gjitha provave, se cili ishte synimi i këtyre materialeve dhe si janë shfrytëzuar.

44. Gjithashtu, Trupi Gjykses është bindur edhe mbi vlerën provuese *prima facie* të gjitha botimeve të tjera të përfshira në të njëjtat dokumente, me përjashtim të

---

<sup>108</sup> Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jогоjore, materialet 55, 69.

<sup>109</sup> *Shih më lart*, poshtëshënimi. 62.

<sup>110</sup> *Shih më lart*, poshtëshënimi. 103.

<sup>111</sup> Vendimi i Dytë mbi Mocionin e Provave Jогоjore, para. 75.



dy dokumenteve që përfshihen në 043801-043801-shin dhe SPOE00056435-SPOE00056435-ën (që janë trajtuar në paragrafin 47), pasi ato kanë lidhje me një nga aspektet e përshkruara më lart a me shumë prej tyre dhe/ose për shkak se duket se këto materiale mbështesin materiale të tjera të pranuar si prova në këtë pjesë të vendimit.<sup>112</sup>

45. Trupi Gjykes është bindur po ashtu se U008-1667-U008-1667 dhe SPOE00199229-SPOE00199230, që janë ribotime të komunikatës 59,<sup>113</sup> dhe SPOE00199392-00199394 dhe IT-03-66 P138 që janë përkthime të deklaratës politike 5 dhe komunikatës 51 që është prezantuar në televizionin shqiptar nga z. Krasniqi,<sup>114</sup> kanë vlerë provuese *prima facie* për shkak se janë shpërndarë nga media të ndryshme dhe ofrojnë prova që mund të jenë relevante për vërtetimin e fakteve dhe rrethanave materiale të kësaj çështjeje gjyqësore.<sup>115</sup> Përmbajtja e tyre është konfirmuar në mënyra të ndryshme nga dokumente të tilla.

46. Në mënyrë të ngjashme, Trupi Gjykes është bindur për vlerën provuese *prima facie* të deklaratave të lëshuara nga Drejtoria e Policisë Ushtarake të UÇK-së (043857-043858, një pjesë e 043862-043862-shit dhe IT-03-66 P146)<sup>116</sup> pasi ato janë botuar në emër të Drejtorisë së Policisë Ushtarake të UÇK-së dhe kanë natyrë provuese lidhur me faktet dhe rrethanat e lidhura me këtë çështje gjyqësore. Për më tepër, ndryshe nga qëndrimi që duket se mban Mbrojtja, ato shërbejnë si provë që tregon se në kohën përkatëse ka ekzistuar Drejtoria e Policisë Ushtarake, dhe nuk tregon falsifikim apo mungesë autenticiteti.

---

<sup>112</sup> Shtojca 1 e Provave Jogojore, materialet 22, 53-54, 57, 58A, 60.

<sup>113</sup> Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materialet 43A, 46.

<sup>114</sup> Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materialet 28A, 34A.

<sup>115</sup> Trupi Gjykes vëren se: (i) U008-1667-U008-1667 dhe SPOE00199229-SPOE00199230 (materialet 43A dhe 46 në Shtojcën 1) janë ribotime të P00159-ës; (ii) SPOE00199392-00199394 (materiali 28A në Shtojcën 1) është përkthim dhe ribotim i 043850-043850-s (materiali 28 në Shtojcën 1); dhe (iii) IT-03-66 P138 (materiali 34A në Shtojcën 1) është përkthim dhe ribotim i komunikatës 51 e cila gjendet edhe në 043801-043801-in (materiali 34 në Shtojcën 1).

<sup>116</sup> Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materialet 49, 53, 53A.

47. Megjithëse Trupi Gjykses është i mendimit se komunikatat dhe deklaratat politike kanë vlera provuese *prima facie*, ai nuk është bindur për vlerën provuese *prima facie* të disa dokumenteve të përfshira në të njëjtat materiale të paraqitura nga ZPS-ja, konkretisht: (i) të deklaratës së Mahmutit me titull “UÇK-ja deri më Tashti Nuk ka Vrarë Asnjë Civil” në 043801-043801-shin;<sup>117</sup> dhe (ii) të deklaratës së Shaban Sinanit në SPOE00056435-SPOE00056435-ën.<sup>118</sup> Më konkretisht, Trupi Gjykses mendon se nuk është e qartë kush ishin këta persona, çfarë posti kanë pasur në UÇK, nëse kanë pasur post, dhe cilat ishin motivet që i shtynë të bënin këto deklaratat dhe nëse ato pasqyrojnë saktë rrëfimet e tyre. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk i pranon këta dokumente si prova jogojore.

48. Trupi Gjykses nuk është bindur për vlerën provuese *prima facie* të: (i) SPOE00209301-00209301-shit pasi, në këtë fazë, ky material ka nevojë për kontekst më të gjerë përmes një dëshmitari;<sup>119</sup> (ii) 019582-019583-shit dhe 019584-019585-ës pasi këto dokumente kanë vlerë të kufizuar provuese në mungesë të deklaratës politike 7, e cila nuk është pranuar si provë;<sup>120</sup> dhe (iii) 043855-043856-ën pasi, në këtë fazë, ky material ka nevojë për kontekst më të gjerë përmes një dëshmitari.<sup>121</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk i pranon këto dokumente si prova jogojore.

49. Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese e dokumenteve në paragrafët 43-46 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues ndaj të akuzuarve. Mbrojtja do të ketë mundësi ta kundërshtojë përmbajtjen e këtyre materialeve gjatë pyetjeve që do t’u bëjë dëshmitarëve përkatës.

50. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses pranon si prova SPOE00209303-00209303-shin, SPOE00209304-00209304-ën, SPOE00209305-00209305-ën,

---

<sup>117</sup> Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 34.

<sup>118</sup> Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 59.

<sup>119</sup> Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 20.

<sup>120</sup> Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materialet 30A, 30B.

<sup>121</sup> Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 33.

SPOE00209306-00209306-ën, SPOE00209307-00209307-ën, SPOE00209308-00209308-ën, SPOE00209309-00209309-ën, SPOE00209311-00209311-shin, SPOE00209312-00209312-shin, SPOE00209302-00209302-shin, SPOE00209429-00209429-ën, SPOE40000792-40000792-shin, SPOE00209430-00209430-n, U016-2148-U016-2148-ën, SPOE40000793-40000793-shin, SPOE00209431-00209431-shin, 043850-043850-n, SPOE00199392-00199394-ën, 043852-043852-in, komunikatat 51-52 që përfshihen në 043801-043801-shin, IT-03-66 P138-ën, 043804-043804-ën, 043806-043806-ën, 043807-043807-ën, U008-1667-U008-1667-ën, 043808-043808-ën, SPOE00199229-SPOE00199230-n, 043857-043858-ën, 043860-043860-n, 043865-043865-ën, 043862-043862-shin, IT-03-66 P146-ën, 043864-043864-ën, SPOE40000799-40000799-ën, U008-1668-U008-1668-ën, SPOE40000796-40000796-ën, komunikatën 69 që përfshihet në SPOE00056435-SPOE00056435-ën, SPOE00056467-SPOE00056467-ën, SPOE40000798-40000798-ën, SPOE00209432-00209432-shin, dhe SPOE00056419-SPOE00056419-ën dhe nuk pranon si prova jogojore U000-0341-U000-0341-shin, 074573-074573-shin, 074575-074575-ën, 074577-074577-ën, 074579-074579-ën, SPOE00209301-00209301-shin, U000-8992-U000-8992-shin, 019582-019583-shin, 019584-019585-ën, 043855-043856-ën, deklaratën e z. Mahmuti që përfshihet në 043801-043801-shin, U000-9943-U000-9943-shin, SPOE00199239-SPOE00199240-n, U000-0519-U000-0519-ën, deklaratën e z. Sinani që përfshihet në SPOE00056435-SPOE00056435-ën, SPOE00313999-00313999-ën dhe SITF00172935-00172935-ën.

### C. VLERËSIMI I PESHËS SË DOKUMENTEVE TË PRANUARA

51. Trupi Gjykses vëren se të gjitha materialet e propozuara të cilat ka gjykuar se janë të pranueshme si prova përmes vendimit aktual përmbushin kushtet për pranim në pajtim me rregullën 138(1). Megjithëkëtë, pranimi si provë nuk është i njëjtë me vendimin se a t'u japë peshë këtyre provave Trupi Gjykses dhe sa. Edhe përcaktimi i vlerës provuese *prima facie* nga Trupi Gjykses nuk është i njëjtë me

vlerësimin e vlerës provuese të provave që Trupi Gjykses do të bëjë në përfundim të gjykimit. Sipas rregullës 139(2), Trupi Gjykses duhet të vlerësojë secilën provë duke mbajtur parasysh tërësinë e provave të administruara në gjykim, dhe gjatë shqyrtimit nëse janë vërtetuar pretendimet faktike, Trupi Gjykses bën një vlerësim dhe peshim tërësor duke i marrë provat në tërësi. Rrjedhimisht, edhe pse ka konstatuar përmes vendimit aktual se disa materiale janë të pranueshme si prova, Trupi Gjykses në fund do të vlerësojë çfarë peshe do të kenë këto materiale në kuadrin e tërësisë së provave që i janë paraqitur gjatë gjykimit.

#### D. SHTYRJA E AFATIT PËR LEJE PËR APELIM

52. Trupi Gjykses vëren se, në pajtim me rregullën 77(1), në rastet kur një palë kërkon të apelojë vendimin e një paneli që nuk është i apelueshëm, pala në fjalë i parashtron kërkesë për leje për apelim panelit që ka nxjerrë vendimin e kontestuar, brenda shtatë (7) ditësh prej daljes së vendimit. Duke pasur parasysh pushimin veror të gjykatës, Trupi Gjykses e mendon të përshtatshme ta ndryshojë afatin për parashtrimin e kërkesës për leje për apelimin e vendimit aktual, në pajtim me rregullën 9(5)(a). Rrjedhimisht, çdo kërkesë e tillë duhet të dorëzohet deri **të hënë, 21 gusht 2023, ora 16:00**. Çdo përgjigje dhe kundërpërgjigje duhet bërë sipas afateve të përcaktuara nga rregulla 76.

#### VI. VENDIM

53. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **MIRATON** pjesërisht Mocionin e Provave Jogojore për dokumentet e Shtojcës 1;
- b) **PRANON** si prova materialet në vijim: U016-2583-U016-2583-ET e rishikuar, U016-2588-U016-2589-ET e rishikuar, U016-2603-U016-2604-ET e rishikuar, U016-2609-U016-2609-ET e rishikuar, U016-2619-U016-

2620-ET e rishikuar, U016-2625-U016-2625-ET e rishikuar, ET U016-2631-U016-2631, U016-2653-U016-2654-ET e rishikuar, U016-2666-U016-2666-ET e rishikuar, ET U016-2667-U016-2668, ET U016-2676-U016-2676, U016-2708-U016-2708-ET e rishikuar, U016-2710-U016-2710-ET, U016-2750-U016-2750-ET, U016-2751-U016-2752-ET, IT-04-84 P00953.E, IT-04-84bis P00147.E, U016-2781-U016-2782-ET, U016-2793-U016-2794-ET, ET U016-2778-U016-2779, IT-04-84 P00934.E, IT-04-84 P00933.E, U016-2621-U016-2621-ET e rishikuar, IT-04-84 P00946.E, U016-2726-U016-2726-ET e rishikuar, ET U016-2762-U016-2762, U008-1607-U008-1607-ET, U008-1608-U008-1608-ET e rishikuar, U008-1609-U008-1609-ET e rishikuar, U008-1610-U008-1610-ET, U008-1611-U008-1611-ET, U003-8552-U003-8690 (f. U003-8566-U003-8567, U003-8571-U003-8571, U003-8611-U003-8612, U003-8660-U003-8660), U008-1615-U008-1615-ET, U008-1616-U008-1616-ET, U008-1618-U008-1618-ET, U008-1620-U008-1620-ET, U008-1622-U008-1622-ET.02, U008-1623-U008-1623-ET, U008-1624-U008-1624-ET e rishikuar, U008-1627-U008-1627-ET e rishikuar, U008-1628-U008-1628-ET e rishikuar, U008-1630-U008-1630-ET e rishikuar, SPOE00209433-SPOE00209433-ET e rishikuar 1, U008-1632-U008-1632-ET, U008-1633-U008-1633-ET, U008-1634-U008-1634-ET, SPOE00209303-00209303, SPOE00209304-00209304, SPOE00209305-00209305, SPOE00209306-00209306, SPOE00209307-00209307, SPOE00209308-00209308, SPOE00209309-00209309, SPOE00209311-00209311, SPOE00209312-00209312, SPOE00209302-00209302, SPOE00209429-00209429, SPOE40000792-40000792, SPOE00209430-00209430, U016-2148-U016-2148, SPOE40000793-40000793, SPOE00209431-00209431, 043850-043850, SPOE00199392-00199394, 043852-043852, komunikatat 51-52 të përfshira në 043801-043801, IT-03-66 P138, 043804-043804, 043806-043806, 043807-043807, U008-1667-U008-1667, 043808-043808, SPOE00199229-SPOE00199230, 043857-043858, 043860-043860, 043865-

- 043865, 043862-043862, IT-03-66 P146, 043864-043864, SPOE40000799-40000799, U008-1668-U008-1668, SPOE40000796-40000796, komunikatën 69 përfshirë në SPOE00056435-SPOE00056435, SPOE00056467-SPOE00056467, SPOE40000798-40000798, SPOE00209432-00209432, dhe SPOE00056419-SPOE00056419;
- c) **UDHËZON** Administratoren t'u caktojë numër të provës materialeve të lartpërmendura, përfshirë përkthimeve;
- d) **REFUZON** në mënyrë jo të prerë pranimin si prova jोगojore të materialeve në vijim: SPOE40000794-40000794, IT-03-66 P142, SPOE00209433-00209433, U000-9948-U000-9948, U000-0516-U000-0516, U000-9963-U000-9963, SITF00316652-00316655, SITF00436539-00436539, ET U016-2577-U016-2578, ET U016-2579-U016-2582, ET U016-2606-A-U016-2606-B, U016-2757-U016-2757-EDT, U016-2775-U016-2775-ET, U003-8552-U003-8690 (f. U003-8580-U003-8585, U003-8586-U003-8590 dhe U003-8623-U003-8624), U008-1625-U008-1625-ET, U008-1635-U008-1635-ET e rishikuar, U003-8552-U003-8690 (me përjashtim të faqeve të pranuar si përkthime të materialeve të tjera të Shtojcës 1), U000-0341-U000-0341, 074573-074573, 074575-074575, 074577-074577, 074579-074579, SPOE00209301-00209301, U000-8992-U000-8992, 019582-019583, 019584-019585, 043855-043856, deklaratën e z. Mahmuti që përfshihet në 043801-043801-shin, U000-9943-U000-9943, SPOE00199239-SPOE00199240, U000-0519-U000-0519, deklaratën e z. Sinani që përfshihet në SPOE00056435-SPOE00056435-ën, SPOE00313999-00313999 dhe SITF00172935-00172935;
- e) **URDHËRON** ZPS-në të përgatisë dhe dorëzojë një provë materiale që të ketë ballinën e U016-2551-U016-2818-ës (Materiali 1 në Shtojcën 1) dhe të gjitha faqet e pranuar të këtij materiali jo më vonë se **të premtën**,



**18 gusht 2023, ora 16:00;**

- f) **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë çdo kërkesë për ruajtjen e konfidencialitetit të çdo materiali të pranuar si provë jo më vonë se **të premten, 18 gusht 2023, ora 16:00**. Çdo përgjigje ndaj saj duhet dorëzuar jo më vonë se **të premten, 25 gusht 2023, ora 16:00**. Nuk do të ketë kundërpërgjigje; dhe
- g) **NDRYSHON** afatin për çdo kërkesë për leje për apelim kundër vendimit aktual dhe **URDHËRON** që çdo kërkesë e tillë të dorëzohet deri të **hënën, 21 gusht 2023, ora 16:00**.

/nënshkrimi/

**Çarls L. Smith, III**

**Kryegjykatës**

E enjte, 27 korrik 2023

Hagë, Holandë.